



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
REKTORI

Nr. 1663 Prot

Shkodër, më 02.07.2020

Lënda: Përcillet për njohje dhe për zbatim Urdhëri nr. 199, datë 30.06.2020 i Rektorit të USH-së.

- Drejtuar:**
1. Fakulteteve të USH-së (të gjithave).
 2. Departamenteve të USH-së (të gjithave).
 3. Administratorit të USH-së.
 4. Studentëve të USH-së (të gjithëve)

Bashkangjitur po ju dërgojmë Urdhërin nr. 199, datë 30.06.2020 të Rektorit të USH-së "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Shkodrës".

Të merren të gjitha masat ligjore nga ana juaj për fillimin e procesit zgjedhor sipas detyrave të përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në "Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Shkodrës", të miratuar me Vendimin nr. 106, datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, për strukturat dhe autoritetet e ngarkuara, duke respektuar afatet e përcaktuara në to.

Në zbatim të neneve 6 dhe 37 të rregullores së lartpërmendur, të njoftohet i gjithë personeli akademik dhe studentët me kohë të plotë e fakultetit tuaj, për të paraqitur kandidaturën e tyre për anëtar të Komisionit Institucinal të Zgjedhjeve në USH dhe të Komisionit të Apelimit të USH-së, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të USH-së, **nga data 02.07.2020 deri me datën 06.07.2020 ora 12.00 (gjithmonë duke u respektuar orari zyrtar 08.00-16.00 dhe ditët e pushimit në R.Sh).**

Aplikimi për anëtar të Komisionit Institucinal të Zgjedhjeve (KIZ), që do bëhet nga studentët, duhet të jetë i shoqëruar edhe me një vërtetim të lëshuar nga fakulteti përkatës, që vërteton që është student me kohë të plotë në atë fakultet.

Kandidatët që aplikojnë për anëtar të Komisionit të Apelimit të USH-së, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 37, pika 2 të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Shkodrës".

Për arsye të situatës në të cilën ndodhemi aktualisht (të shkaktuar nga Covid-19), aplikimi mund të bëhet edhe në rrugë elektronike në adresën: mirjam.dibra@unishk.edu.al.

Bashkëngjitur modelet e formularit të vetëkandidimit.

Të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana juaj për zhvillimin e këtij procesi në përputhje me rregullat e përcaktuara në Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në “Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës”, të miratuar me Vendimin nr. 106, datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTORI

Prof. Dr. Adem BEKTESHI

